



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr.02/1019

Datë: 20.11.2023

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas neneve 53 dhe 57 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe në bazë të nenit 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, lidhur me Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

I. Themelohet Komiteti Komunal Veprues (KKV).

II. Komiteti Komunal Veprues themelohet në këtë përbërje:

1. Yllka Fejzullahu – Drejtoreshë e Drejtorisë Komunale për Arsimit;
2. Muharrem Asllani-Drejtor i Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
3. Grejtalb Emini-Drejtor i Drejtorisë Komunale për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi ;
4. Elfete Shabani -Zyrtar për Komunitete dhe Kthim;
5. Reshat Gashi - Zyrtari Komunal për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrtar për barazi gjinore
6. Fatmire Ferati-Zyrtare në DKRS
7. Kimete Uka - Zyrtari kryesor për financa
8. Bajram Ilazi - përfaqësuesi i OJQ " VORAE"- Graçanicë
9. Muhamet Mehmeti- përfaqësues i OJQ " Balkan Sunfloëers Kosova "-Prishtinë;
10. Arjeta Maliqi- përfaqësues i OJQ lokale "Bashkimi Rinor për Bashkëveprim"-Shtime ";
11. Shaban Kurti – përfaqësues i OJQ lokale " Art Stars Union-Shtime.

III. Komiteti Komunal Veprues do të bëjë monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit 2022-2024. Përveç monitorimit, KKV do të funksionojë si një strukturë mbështetëse lokale për koordinimin e aktiviteteve me Ministrinë e Adminmistrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrën e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, në kuadër të procesit të zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë.

IV. Përmes këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi nr. 02/245 i datës 18.04.2023.

V. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Kryetari i Komunës

Qemajt Aliu

